

# THE KOSOVO BANKER

## Bankingu 2020



Qershor 2017 Numër 11 Publikim i Shoqatës së Bankave të Kosovës


SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION





TebMobile

Të gjitha  
**shërbimet bankare**  
në një **aplikacion!**



**TEB**

BNP PARIBAS JOINT VENTURE

teb-kos.com / 038 230 000



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION



# THE KOSOVO BANKER

## IMPRESSUM

### BORDI I DREJTORËVE TË SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS



**Z. Ilir I. Aliu**  
Kryetar i Bordit,  
ProCredit Bank



**Z. Robert Wright**  
Zv. Kryetar i Bordit,  
Raiffeisen Bank



**Znj. Merita  
Gjyshinca-Peja**  
Banka Ekonomike



**Z. Abdurrahman Balkiz**  
Banka Kombëtare  
Tregtare



**Z. Arton Celina**  
Banka për Biznes



**Z. Alper Karakoç**  
IS Bank



**Z. Lavdim Koshutova**  
NLB Prishtina



**Z. Orcun Ozdemir**  
TEB Bank



**Z. Meriton Sunduri**  
Ziraat Bank

### DREJTOR EKZEKUTIV I SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS DHE KRYEREDAKTOR:

Z. PETRIT BALIJA

### ZYRTARE E KOMUNIKIMIT DHE REDAKTORE:

ZNJ. MIRANDA RUGOVAJ



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

### Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK)

përfaqëson sektorin bankar në Kosovë duke bashkëpunuar me Qeverinë, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, organizatat ndërkombëtare dhe shoqëritë civile, mediat dhe publikun. Qëllimi i SHBK-së është të mbështesë një sistem të shëndoshë bankar dhe konkurrencë të drejtë dhe të hapur, si dhe edukimin financiar për klientët bankarë, dhe në këtë mënyrë të nxisë zhvillimin ekonomik afatgjatë në Kosovë. SHBK lehtëson bashkëpunimin ndërmjet bankave duke ofruar një platformë të vetme për të diskutuar iniciativat e reja. SHBK gjithashtu identifikon dhe rishikon nismat ligjore dhe rregullative, koordinon aktivitetet e përbashkëta për sektorin bankar, dhe promovon aktivitetet bankare tek audienca e gjerë. E themeluar në vitin 2002, SHBK është pika e referimit në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me sektorin bankar në Kosovë. Aktualisht, SHBK përfaqëson nëntë banka komerciale: Banka Ekonomike, Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Banka për Biznes (BpB), IsBank, NLB Banka, ProCredit Bank, Raiffeisen Bank, TEB Bank dhe Ziraat Bank. Brenda SHBK-së operon Qendra për trajnime Bankare, e cila ofron trajnime në fushën e bankave dhe të financave. SHBK është zëri i industrisë bankare në Kosovë.

"The Kosovo Banker" është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Botohet dy here në vit, me qëllim të informimit të saktë të publikut lidhur me industrinë bankare në Kosovë. Shoqata e Bankave të Kosovës; Rr. Lidhja e Pejes p.n, Zona Industriale, Prishtinë; 10000. Republika e Kosovës; +381 38 246 171; www.bankassoc-kos.com; contact@bankassoc-kos.com.

THE KOSOVO BANKER  
MBËSHKETET NGA FONDI  
EVROPIAN PËR EVROPËN  
JUGLINDORE -DEPARTAMENTI  
PËR ZHVILLIM (EFSE-DF)



EUROPEAN FUND FOR SOUTHEAST EUROPE  
DEVELOPMENT FACILITY

# PËRMBAJTJA

## EDITORIALI 1

## FJALA E KRYETARIT TË RI-ZGJEDHUR TË BORDIT TË SHBK-SË 3

## 1.0 SEKTORI FINANCIAR 4

- Ndryshimi është i pashmangshëm. Ndryshimi është i vazhdueshëm -Robert Wright, Raiffeisen Bank.
- Kërkesat e përlogaritjes së rënjes në vlerë sipas SNRF 9: Elementet Kryesore dhe Sfidat -Faton Ramadani -IsBank

## 2.0 KËNDI I EKSPERTËVE 10

- Sigurimi i Aftësisë Paguese Financiare nëpërmjet Shitjes së Borxhit -Katerina Bosevska, EOS Matrix L.L.C Dega në Kosovë
- SNRF 9 dhe ndryshimet kryesore në SNK 39 -Arta Limani, Arian Meta -Deloitte Kosova sh.p.k

## 3.0 EKONOMI 17

- Sjellja me përgjegjësi në një mjedis të ulët të normës së interesit -Perspektiva e një Banke Qendrore

## 4.0 KËNDI I EDUKIMIT FINANCIAR 21

- Llogaritja e kapacitetit huamarrës: sa mund të merrni hua?

## 5.0 TRAJNIMET NË SHBK 25

- Menaxhimi i Rrezikut të Likuiditetit të Bankës sipas Basel III dhe Kërkesat për Kapital sipas Direktivës IV (CRD4)
- Programi Ndërkombëtar i Certifikimit për Pajtueshmëri - Niveli bazik

- IFRS9 - Humbjet e Pritura nga Huadhënia
- Auditim dhe Kontrolli i Brendshëm
- Menaxhimi i Rrezikut Kreditor
- Takimi i Asamblesë së Përgjithshme të SHBK-së, 25 Maj, 2017

## 6.0 NJOFTIME NGA BANKAT 27

- Banka Ekonomike dhuron donacion për SOS Fshatrat e Fëmijëve
- Banka Kombëtare Tregtare nënshkruan marrëveshjen me Fondin Kosovar për Garanci Kreditorë
- Në bankën e vendit, fëmijët mësojnë për kursime
- Banka e vendit në përkrahje të prodhimeve të vendit
- BERZH i jep çmimin NLB Bankës si 'Banka më aktive për lëshimin e Garancioneve në Kosovë në vitin 2016'
- Banka ProCredit, partner shumëvjeçar i Dokufest
- Banka ProCredit mbështet "Gjysmë Maratonën Prishtina 2017"
- Banka Raiffeisen përkrahë projekte të ndryshme në mbarë vendin
- "Gender Award" nga BERZH për TEB Sh.A.
- TEB Sh.A. ofron shërbimeve jo financiare për gratë ndërmarrëse

**Deklarim i përgjegjësishë:** Pikëpamjet e shprehura në shkrimet e revistës janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet apo politikat e Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) dhe Fondit Evropian për Evropën Juglindore -Development Facility (EFSE-DF). SHBK dhe EFSE-DF nuk mbajnë përgjegjësi mbi përmbajtjen e artikujve të autorëve të publikuar në revistën "The Kosovo Banker".



# ***BKT ju informon në kohë reale!***



**BKT Mobile**

12:29

**\*\*** Me kënaqesi ju informojmë se paga juaj  
u kreditua në llogari.  
Dite të mbarë!

*Jeni gjithmonë në dijeni  
se çka po ndodhë me  
llogarinë tuaj*


- *Transfertat hyrëse*
- *Pagesat*



038 666 666 | [www.bkt-ks.com](http://www.bkt-ks.com)

Ne jemi gjithmonë këtu!

# EDITORIAL



## Z. PETRIT BALIJA

DREJTOR EKZEKUTIV

SHOQATA E BANKAVE  
TË KOSOVËS


***Bankingu si term, nënkupton përdorimin e shërbimeve bankare nga klientët por edhe mënyrën e të bërit biznes dhe ofrimit të shërbimeve nga ana institucioneve bankare.***

Bankingu 2020, si temë kryesore e këtij edicioni, ka për qëllim të hedh dritë mbi atë që është duke ndodhur në arenën ndërkombëtare financiare por me ndikime të saj edhe në sektorin bankar në Kosovë. Këto zhvillime po ndryshojnë Bankingun si për institucionet bankare ashtu edhe për klientët e tyre dhe sigurisht edhe për bankat qendrore si nxitës të një sistemi financiar stabil dhe efikas.

Zgjerimet rregullative, avancimet në digjitalizimin e shërbimeve, hyrjet në treg të institucioneve jo-bankare Fintech, rritja e kërkesave dhe ndryshimi i shpejt i kërkesave nga klientët, rritja e plogësht ekonomike,

normat negative të interesit të aplikuara nga Banka Qendrore Evropiane, rritja e kërkesave ligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, rritja e kostove të menaxhimit të parasë së gatshme dhe rëndësia e sigurisë kibernetike, janë vetëm disa nga zhvillimet globale të cilat po ndryshojnë Bankingun në mënyrë drastike. Këto ndryshime po marrin formë gjithnjë e më shumë tek sa jemi duke avancuar drejt vitit 2020. Viti 2020 konsiderohet si një pikë kohore ku mund të reflektohet mbi transicionet e ndryshme të cilat kanë filluar në fund të shekullit 20 dhe po formësohen dhe definojnë në dy dekadat e para të shekullit 21 për ti dhënë mundësi krijimit të një etape të re kohore për zhvillime krejtësisht të reja të shekullit 21 në shumë aspekte të Bankingut.

Në këtë edicion do të gjeni artikuj të cilët trajtojnë këto aspekte në detaje duke bërë një analizë të thuktë të këtyre zhvillimeve. Përveç artikujve të trajtuar me një ekspertizë



të lartë, në këtë edicion janë përfshirë edhe informacione të natyrës së edukimit financiar të cilat janë të rëndësishme për secilin qytetar, respektivisht klientë të bankave.

Cilat janë ndikimet e politikave monetare dhe rregullatives së Autoritetit Bankar Evropian dhe Bankës Qendrore Evropiane mbi sektorin bankar të Kosovës? Si i shohin bankat në Kosovë këto zhvillime dhe sa do të mund ti përshtaten këtyre ndryshimeve? Cilat janë pritjet e bankave në Kosovës për digjitalizimin e shërbimeve? Si do të ndryshojnë teknikat për menaxhimin e rrezikut dhe cilat janë mundësitë e reja të menaxhimit të kredive jopërfomuese? Si mund të llogaritet kapaciteti i juaj huamarrës? Për të gjitha këto pyetje dhe më shumë do të gjeni përgjigjet në këtë edicion. Gjithashtu, do të gjeni dhe informacione tjera shtesë për aktivitetet e Shoqatës së Bankave të Kosovës dhe bankave komerciale.

Duke falënderuar Bankat Komerciale të Kosovës dhe EFSE –Departamenti për Zhvillim, si dhe të gjithë autorët që kontribuan në realizimin e këtij edicioni, ju uroj lexim të këndshëm dhe punë të mbarë në pjesën e dytë të vitit 2017!

Me respekt,

*Petrit Balija*

Drejtor Ekzekutiv  
Shoqata e Bankave të Kosovës

# FJALA E KRYETARIT TË RI-ZGJEDHUR TË BORDIT TË SHBK-SË

Duke u ndjerë i nderuar dhe i privilegjuar që jam rizgjedhur Kryetar i Bordit të Drejtorëve të Shoqatës së Bankave të Kosovës për një mandat të dytë, mbetem i angazhuar që të vazhdoj të kontribuoj në këtë organizatë të rëndësishme, që është zëri i sektorit bankar dhe ka për qëllim të mbështesë zhvillimin e një sektori bankar të shëndetshëm, stabil dhe në rritje.

Duke reflektuar mbi rezultatet e sektorit bankar në Kosovë për gjashtë muajt e parë të vitit 2017, është më se evidente që indikatorët e performancës janë duke u përmirësuar në çdo aspekt: a) është përmirësuar qasja në financa për bizneset si dhe për klientët individë, b) është përmirësuar kualiteti i aseteve të sektorit bankar, c) janë përmirësuar kushtet e kreditimit, d) është përmirësuar kualiteti i shërbimeve përmes teknologjisë dhe inovacionit si dhe e) është mbajtur stabile shkalla e profitit për sektorin.

Duke filluar nga qasja në financa për bizneset dhe individët, rezultatet tregojnë që bankat kanë lëshuar kredi me një ritëm mjaft dinamik prej afër 10% rritje vjetore. Kjo paraqet rritjen më të lartë të kreditimit në pesë vitet e fundit, gjë që tregon që sektori bankar është duke operuar me një shkallë të lartë të angazhimit në ekonomi duke kontribuar në masë të madhe në zhvillimin dhe zgjerimin e sektorit real. Për më tepër, sektori bankar në Kosovë, me mbështetje të Bankes Qendrore të Kosovës ka arritur të mbajë kreditë jo-performuese (NPL) në nivel shumë të ulët, duke arritur nivelin më të ulët prej 4.3% në maj 2017. Ky nivel i NPL është rezultat i maturisë nga të dyja palët, nga rregullatori dhe bankat komerciale që operojnë në Kosovë, si dhe është njëri ndër sektorët me performancën më të mirë në rajon.

Vlerësimi më i mirë i rrezikut u ka mundësuar bankave të përmirësojnë kushtet e kreditimit duke përmirësuar vazhdimisht koston e financimit, me normen mesatare të interesit për kreditë duke arritur nivelin nën 7% në mars të vitit 2017. Një shembull shumë i mirë sa i përket këtij zhvillimi është raportuar nga BQK në raport duke theksuar që norma mesatare e interesit në agro-kredi ka qëndruar në nivelin 6.2%, krahasuar me dy vite më parë kur kjo normë mesatare ishte raportuar 10%. Përveç kësaj, kualiteti i shërbimeve,

## Z. ILIR ALIU

KRYETAR I BORDIT TË DREJTORËVE TË SHBK

CEO, PROCREDIT BANK KOSOVO



disponueshmëria dhe lehtësia e përdorimit është rritur pasi që bankat kanë zgjeruar kanalet e tyre të distribuimit dhe kanë investuar në teknologjinë më të re, duke siguruar gjithëpërfshirje dhe efikasitet. Përkundër rënies së normës së interesit, sektori bankar ka rritur që të mbajë profite stabile falë rritjes së portfolios kreditore (që nga viti 2016 totali i portfolios kreditore të sektorit bankar në Kosovë është 700 milionë euro më i lartë duke e krahasuar me vitin 2010), si dhe duke rritur efikasitetin operacionale. Ky indikator së bashku me indikatorët e tjerë të performancës si dhe shërbimet inovative tregojnë qartazi që sektori bankar është sektori më i suksesshëm në Kosovë në këto shtatëmbëdhjetë vitet e fundit. Kjo gjithashtu është konfirmuar si në raportet kombëtare gjithashtu edhe ato ndërkombëtare.

Indikatorët e përmendur më lartë janë shoqëruar me investime në teknologji të reja dhe shërbime të pagesave nga të dyja anët, nga ana e bankave si dhe nga ana e Bankes Qendrore të Kosovës duke përmirësuar shpejtësinë dhe sigurinë e sistemit të pagesave. Është pjesë e angazhimit tonë që të vazhdojmë përpjekjet të modernizojmë shërbimet bankare dhe të rritet efikasiteti dhe lehtësia e përdorimit të shërbimeve bankare si masë e zhvillimit dhe zgjerimit të mëtejshëm. Në emër të Bordit të Drejtorëve të Shoqatës së Bankave të Kosovës si dhe stafit të saj të përkushtuar dhe profesional, dëshiroj të falenderoj akterët kyç të sektorit dhe të bëj thirrje që të vazhdohet me avancimin e legjislacionit dhe implementimin e tij konsistent, e që është parakusht në mënyrë që sektori të operojë suksesshëm si dhe të jap rolin e tij zhvillues.



## NDRYSHIMI ËSHTË I PASHMANGSHËM. NDRYSHIMI ËSHTË I VAZHDUESHËM.

*(Benjamin Disraeli Kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar 1874)*

Nëse ka një gjë që është e sigurt në jetë është ndryshimi, dhe duke shikuar përpara në vitin 2020, ka 3 ndryshime kryesore që vijnë në industrinë bankare të Kosovës, të cilat do të kenë pasoja të rëndësishme për bankat, klientët, dhe të gjithë ata që në një mënyrë lidhen me industrinë bankare. Këto ndryshime janë bankingu digjital, siguria kibernetike, dhe rregullimi.

### Bankingu digjital

Bill Gates dikur tha: "Ne gjithmonë mbivlerësojmë ndryshimin që do të ndodhë në dy vitet e ardhshme dhe nënvlerësojmë ndryshimin që do të ndodhë në dhjetë vitet e ardhshme." Mendoj se kjo është shumë e vërtetë dhe kjo pikëpamje mund të zbatohet edhe për bankat e Kosovës. Ju lutem mos më keqkuptoni, ritmi i ndryshimit është i shpejtë në industrinë bankare të Kosovës, por në vitin 2020 prap do të ketë degë bankare me transaksione manual dhe ne do të vazhdojmë t'u mësojmë klientëve se si të përdorin bankomatit dhe paisjet POS për herë të parë. Megjithatë, kemi arritur një rrugë të gjatë në një kohë të shkurtër dhe Bankat janë të njohura në mbarë botën si adoptues të hershëm të teknologjive të reja. Industria bankare në Kosovë nuk është e ndryshme dhe ka përqafuar me shpejtësi teknologjitë e reja bankare për të ndihmuar klientët të kenë një eksperiencë bankare me përparësi. Bankomatët, терминалет POS, kartelat pa kontakt, bankingu në internet, bankingu në mobil, qendrat e thirrjeve, dhe zonat e vetë-shërbimit janë vetëm disa shembuj të përparimeve të bëra nga bankat në Kosovë; dhe e gjithë kjo ka ndodhur në një hapësirë të shkurtër kohore në krahasim me vendet e Evropës Perëndimore, siç ilustron diagrami më poshtë:

















### Z. ROBERT WRIGHT

ZV. KRYETAR I BORDIT TË  
DREJTORËVE TË SHBK

CEO, RAIFFEISEN BANK  
KOSOVO J.S.C.



**Industria bankare në Kosovë nuk është e ndryshme dhe ka përqafuar me shpejtësi teknologjitë e reja bankare për të ndihmuar klientët të kenë një eksperiencë bankare me përparësi. Bankomatët, терминалет POS, kartelat pa kontakt, bankingu në internet, bankingu në mobil, qendrat e thirrjeve, dhe zonat e vetë-shërbimit janë vetëm disa shembuj të përparimeve të bëra nga bankat në Kosovë; dhe e gjithë kjo ka ndodhur në një hapësirë të shkurtër kohore në krahasim me vendet e Evropës**

Si u zhvillua bankingu Britanez?	<b>1966</b>	<b>1967</b>	<b>1986</b>	<b>1987</b>	<b>1997</b>	<b>2003</b>	<b>2007</b>	<b>2010</b>	
	Kredit kartela e parë, Barclaycard	Bankomati i parë	Ligji u lejon bankave të shesin hipoteka	Kartela e parë e debitit	Shërbimi i parë elektronik i bankingut	Kartela e parë me chip dhe PIN	Transaksioni i parë me kartelë pa kontakt (contactless)	Aplikacionet mobile për bankim janë vënë në përdorim	
									
	Si u zhvilluar Bankingu Kosovar?	<b>2007</b>	<b>2002</b>	<b>2006</b>	<b>2002</b>	<b>2005</b>	<b>2007</b>	<b>2016</b>	<b>2010</b>
		Kartela e Kreditit, Raiffeisen Bank Kosovo	Bankomati i parë	Produkti i parë për Kredi Hipotekare	Kartela e parë e debitit	Shërbimi i parë elektronik i bankingut	Kartela e parë me chip dhe PIN	Transaksioni i parë me kartelë pa kontakt (contactless)	Aplikacionet mobile për bankim janë vënë në përdorim
									

Nuk ka absolutisht asnjë dyshim se ky trend do të vazhdojë dhe deri në vitin 2020, ku do të shohim më shumë teknologji digjitale të zbatuara nga bankat, në veçanti më shumë shërbime nëpërmjet telefonave celularë, e cila gjithnjë e më shumë është kanali i preferuar për shumë konsumatorë. Besoj se shumë banka në Kosovë do të kalojnë shërbimet e bankingut mobil si mjeti primar për angazhimin e konsumatorëve deri në vitin 2020. Nëpërmjet aplikacioneve mobile, bankat do të bëhen pjesë integrale e çështjeve financiare të klientit në shumë aspekte të jetës së tyre qoftë ajo për blerjen e një shtëpie të re, blerjen e një makine, pagesën ndaj një miku, apo blerjen online. McKinsey, konsulencia globale, kohët e fundit deklaroi se bankat kryesore së shpejti do të ndërlihen online me klientët 12-15 herë në ditë në krahasim me 3 ose 4 herë në ditë për bankat tradicionale. Aftësia për të bërë këtë do të kërkojë që bankat të kenë të dhëna analitike në kohë reale dhe të sofistikuara në mënyrë që propozimet e përshtatura dhe relevante të mund të dorëzohen tek klientët. Kjo do të jetë një sfidë e rëndësishme për industrinë dhe një faktor kyç në zbatimin e suksesshëm të këtij zhvillimi është se Kosova duhet të bëhet digjitale në shumë fusha të jetës, jo vetëm në industrinë bankare. Shitësit me pakicë, ofruesit e shërbimeve, institucionet qeveritare, dhe shumë pjesëmarrës të tjerë në jetën e përditshme të klientit gjithashtu duhet të bëhen digjital. Krijimi i vlerës dhe përfitimeve nga ofrimi i një propozimi bankar digjital

humbet nëse një pjesë e procesit të ndërlihdjes me palët e treta është ende manuale ose ose si shërbim me prezencë fizike.

Në vitin 2020, degët e bankave do të mbeten të rëndësishme, por do të përqendrohen më shumë në aktivitetet këshilluese dhe gjeneruese të tarifave se në shërbimet tradicionale. Deri në vitin 2020, zonat e vetë-shërbimit do të jenë të zakonshme dhe ekonomia kosovare e bazuar në para të gatshme do të jetë në rënie, por për fat të keq unë besoj se në mënyrë të papranueshme ajo do të vazhdojë të mbetet një pjesë e rëndësishme e ekonomisë së Kosovës.

Deri në vitin 2020 mund të shohim FinTech-un e parë në Kosovë. FinTech-et po riorganizojnë industrinë bankare botërore dhe shumë prej tyre do të përpiqen të shfrytëzojnë mundësitë e Direktivës së Shërbimeve të Pagesave 2 (PSD2) që organizatat mëmë të bankave të huaja në Kosovë po e adresojnë tashmë. Në afat të shkurtër, Kosova si jo anëtare e BE-së, nuk është e detyruar të jetë në pajtueshmëri me PSD2, megjithatë ka ende mundësi për shërbime të pagesave që do të interesojnë FinTech-et. Me 80% penetrimit të internetit dhe një popullsi me një moshë mesatare prej 26 vjeç, Kosova përfaqëson një mjedis ideal për teknologjitë e reja të bankingut digjital dhe bankat mund të sfidohen nga FinTech-et të cilët mund të ofrojnë pagesa të thjeshta dhe të lira në avantazh dhe lehtësira të tjera të transaksionit.

Gjithashtu është shumë e rëndësishme që deri në vitin 2020 Banka Qendrore e Kosovës të paraqesë legjislacion dhe teknologji që do të mbështesë një mjedis bankar digjital, pasi që teknologjitë e reja digjitale do të sjellin mundësi të reja, por gjithashtu sfida dhe rreziqe të reja. Një nga këto rreziqe është krimi kibernetik dhe siguria kibernetike.

---

**Nuk ka absolutisht asnjë dyshim se ky trend do të vazhdojë dhe deri në vitin 2020 do të shohim më shumë teknologji digjitale të zbatuara nga bankat, në veçanti më shumë shërbime nëpërmjet telefonave celularë, e cila gjithnjë e më shumë është kanali i preferuar për shumë konsumatorë. Besoj se shumë banka në Kosovë do të kalojnë shërbimet e bankingut mobil si mjeti primar për angazhimin e konsumatorëve deri në vitin 2020.**

---

## **Siguria kibernetike**

Siguria efektive dhe e besueshme kibernetike është me rëndësi të veçantë nëse industria bankare do të fitojë besimin e klientit në bankingun digjital. Kohëve të fundit kemi parë një sulm global ransomware ku shumë kompani të njohura u prekën dhe humbjet e mundshme u barazuan me miliarda dollarë. Për fat të mirë, nuk është raportuar ndonjë ndikim i madh në Kosovë por, kjo nuk do të thotë se jemi të sigurt. Ndërsa vendet perëndimore me përvojë në fushën e sigurisë kibernetike duke futur legjislacionin e duhur dhe duke krijuar njësi të veçanta kibernetike, Kosova është ende në fazat e hershme të zhvillimit dhe duhet të japë prioritet më të lartë në të ardhmen e afërt. Aktualisht bankat e Kosovës, nëpërmjet Shoqatës së

Bankave të Kosovës, kanë bashkëpunim të mirë në fushën e sigurisë siç është parë kohët e fundit me incidentet e sigurisë në lidhje me bankomatët, dhe ky bashkëpunim tani kërkon zhvillim të mëtejshëm në fusha të tilla si digjitalizimi dhe siguria kibernetike. Kjo do të jetë një situatë shumë më e komplikuar dhe teknikisht më kërkuese sesa trajtimi i incidenteve relativisht të thjeshta të bankomatëve.

---

**Siguria efektive dhe e besueshme kibernetike është me rëndësi të veçantë nëse industria bankare do të fitojë besimin e klientit në sistemin bankar digjital. Kohëve të fundit kemi parë një sulm global ransomware ku shumë kompani të njohura u prekën dhe humbjet e mundshme u barazuan me miliarda dollarë. Për fat të mirë, nuk është raportuar ndonjë ndikim i madh në Kosovë**

---

## **Rregullat**

Disa thonë se industria bankare evropiane meriton rritjen dramatike të rregullatës dhe mbikëqyrjes që ka ndodhur gjatë shtatë apo tetë viteve të fundit që nga kriza financiare e 2009/10. Rritja e madhe e të gjithë treguesve kryesorë kyç të performancës në industrinë bankare gjatë dekadës para krizës, plus aktivitetet ilegale ose, në rastin më të mirë, aktivitetet jo-transparente nga disa banka dhe obsesioni me rritjen e vlerës për aksionarët, kontribuan në krizën dhe mungesën e rregullimit dhe mbikëqyrjes që ishte gjithashtu një faktor kontribues. Si pasojë, ne përballemi sot me një sasi të madhe ndryshimesh rregullatore, mbikëqyrëse, dhe strukturore. Diagrami më poshtë tregon atë që aktualisht është në axhendën e bankave Evropiane.



Meqenëse Kosova nuk është anëtare e BE-së, industria bankare ende nuk është e obliguar të jetë në pajtueshmëri me të gjitha rregulloret dhe politikat e Autoritetit Europian të Bankave ose të Bankës Qendrore Evropiane, por ne ende kemi një varg të rëndësishëm dhe sfidues të ndryshimeve ligjore dhe mbikëqyrëse për të adresuar.

Për shembull, rregulloret e Basel II, IFRS9, dhe ato kundër shpërlarjes së parave janë aktualisht prioritetet kryesore për bankat e Kosovës. Për më shumë, bankat ndërkombëtare në Kosovë gjithashtu duhet të jenë në përputhje me disa rregullore dhe procedura të AEB dhe BQE, pasi që banka e tyre mëmë është e vendosur në BE. Shoqata e Bankave të Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës, zyra përfaqësuese e FMN-së në Prishtinë, dhe institucionet

përkatëse qeveritare po punojnë së bashku për të arritur afatet e ndryshme të zbatimit të detyrueshëm.

Me sa duket rregullorja e Basel I përbëhej nga 30 faqe, rregullorja e Basel II mbulonte 347 faqe, dhe Basel III ishte voluminoze prej 616 faqe. Deri në vitin 2020 do të trajtojmë Baselin IV. Sa faqe do të jetë kjo?!

---

**Rregulloret e Basel II, IFRS9, dhe ato kundër shpërlarjes së parave janë aktualisht prioritetet kryesore për bankat e Kosovës**

---

## KËRKESAT E PËRLLOGARITJES SË RËNJES NË VLERË SIPAS SNRF 9: ELEMENTET KRYESORE DHE SFIDAT

Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) përfundoi elementin përfundimtar të përgjigjes së saj gjithëpërfshirëse ndaj krizës financiare me publikimin e Standardit Ndërkombëtarë të Raportimit Financiar (SNRF) 9 Instrumentet Financiare në Korrik 2014. Paketa e përmirësimeve të prezantuara nga SNRF 9 përfshin një model logjik për klasifikim dhe matje, një model i vetëm i përlllogaritjes së rënjes në vlerë (ang. Impairment) për të ardhmen për "humbjet e parashikuara" dhe një qasje thelbësisht e reformuar ndaj kontabilitetit mbrojtës. Standardi i ri do të hyjë në fuqi më 1 Janar 2018, me zbatim të hershëm të lejuar.

Përlllogaritja e rënjes në vlerë sipas SNRF 9 ka paraqitur ndryshime radikale themelore në përlllogaritjen e rënjes në vlerë. Në të kaluarën SNK 39, rënja në vlerë e aktiveve financiare njihej duke përdorur një 'model të humbjeve të pësuar'. Ky model supozon që të gjitha kreditë do të paguhen derisa të identifikohet evidenca për të kundërtën (e njohur si një ngjarje e humbjes ose e shkaktuar). Pra, ajo u bazua në të dhënat historike, prandaj është konsideruar si model i bazuar në të kaluarën.

Në krahasim me SNK 39, SNRF 9 përdor modelin e humbjeve të pritshme, i cili konsiderohet si model i ardhshëm. Përderisa humbja e pësuar është e sigurtë, është e kaluar dhe është e lehtë për t'u matur, e ardhmja është më e vështirë për t'u përcaktuar dhe për t'u vlerësuar. Për shkak të këtij fakti, teknika gjithëpërfshirëse të menaxhimit të rrezikut duhet të përdoren.

Nga këndvështrimet praktike, cili është ndikimi? Në SNK 39, rënjet në vlerë janë regjistruar nëse ka pasur një ngjarje të mospagesës. Pra, ishte veprim i vonuar, ndërsa në SNRF 9 rënja në vlerë do të regjistrohet nga dita e parë e disbursimit të kredisë sepse që nga dita e parë konsiderohet si humbje e pritshme. Pra, ndikimi në pasqyren e të ardhurave është me të vërtetë i rëndësishëm dhe material. Bazuar në rezultatet nga vlerësimi i ndikimit të SNRF 9 të lëshuar nga Autoriteti Bankar Evropian (EBA) në Nëntor 2016, rritja e parashikuar e provizioneve krahasuar me nivelet aktuale të provizioneve sipas SNK 39 është nga



**Z. FATON  
RAMADANI**

MENAXHER I RISKUT

ISBANK -DEGA NË  
KOSOVË

18% deri në 30% mesatarisht për shumicën e bankave.

**SNRF 9 përdor modelin e humbjeve të pritshme, i cili konsiderohet si model i ardhshëm. Përderisa humbja e pësuar është e sigurtë, është e kaluar dhe është e lehtë për t'u matur, e ardhmja është më e vështirë për t'u përcaktuar dhe për t'u vlerësuar. Për shkak të këtij fakti, teknika gjithëpërfshirëse të menaxhimit të rrezikut duhet të përdoren.**

Aspekti i parë që është element kyç për Bordin e Drejtorëve të bankave është se modeli i përkeqësimit të pritshëm të kredisë sipas SNRF 9 ndikon në Pasqyrën e të Ardhurave dhe përcakton në fund kërkesën minimale të kapitalit. Kërkesa minimale e kapitalit është shumë e rëndësishme, por është një kusht i paqëndrueshëm.

Aspekti i dytë është humbja e pritshme në jetëgjatësi. Kush mund ta di se çfarë do të jetë humbja e pritshme gjatë jetës së kredive hipotekare për pesëmbëdhjetë vjet? Vetëm Zoti e di! Pra, ky është shqetësim që vërtet është diçka e panjohur.

Aspekti i tretë që shqetëson Bordin është zbatimi operacional i SNRF 9. Kjo është një sfidë e madhe për çdo bankë.

**Pra, zhvillimi i modeleve që bankat tashmë kanë në mënyrë që të ndërtojnë modelet e SNRF 9 dhe t'i bëjë ato të qëndrueshme, është sfiduese për shumicën e bankave në Evropë dhe mendoj se kjo do të jetë edhe sfida kryesore për bankat në Kosovë.**

Bankat nuk do të jenë në përputhje me SNRF 9 duke përdorur modelin e riskut të kredisë. Arsyeja është se do të ketë shumë dallime në mes të modeleve të riskut. Dallimi i parë është horizonti kohor. Sipas SNRF 9, horizonti kohor kërkon llogaritjen e humbjeve të kredisë përgjatë jetëgjatësisë, ndërsa zakonisht në një model kredie përdoret një vit. Dallimi i dytë është se SNRF 9 merr pikëpamjen e tashme të kohës së raportimit. Pra, kjo është një pikëpamje me një pikë kohore, ndërsa nën riskun e zakonshëm të kredisë apo sipas Basel-it është përmes një cikli kohorë. Ndryshimi i tretë është se SNRF 9 përdor normën efektive të interesit për të skontuar flukset e mjeteve monetare. Krahas kësaj, modelet sipas SNRF 9 gjithashtu do të duhet të përdorin faktorët makroekonomikë dhe gjithashtu do të duhet të përdorin skenarë të ndryshëm të cilët ndoshta nuk përdoren sipas modeleve aktuale të riskut të kredisë.

Pra, zhvillimi i modeleve që bankat tashmë kanë në mënyrë që të ndërtojnë modelet e SNRF 9 dhe t'i bëjë ato të qëndrueshme, është sfiduese për shumicën e bankave në Evropë dhe mendoj se kjo do të jetë edhe sfida kryesore për bankat në Kosovë.

Sfida e parë është transformimi i udhëzimeve të SNRF 9 në politika dhe procedura. Bankat duhet të kenë përkufizimin e tyre se çfarë është mospagesa, çfarë do të thotë risk i ulët i kredisë për bankën dhe për çdo produkt. Sfida e dytë është zbatimi i politikave në praktikë. Pra, ka nevojë për mbështetjen e sistemit për të ndihmuar zbatimin e politikave që duhet të jenë fleksibël sepse udhëzimet e SNRF 9 janë të fiksuara dhe politikat e procedurat mund të ndryshojnë me kalimin e kohës.

Sfida e tretë është integrimi dhe harmonizimi i riskut dhe financave. Risku nga dita e parë llogarit humbjen e pritshme të kredisë dhe që nga dita e parë në financë e regjistrojnë atë si rënje në vlerë të kredive. Pra, që nga dita e parë ajo duhet

të bashkërendohet çdo herë dhe të sigurohet që ato të jenë konsistente dhe kjo mund të ndodhë vetëm kur zgjidhjet e rrezikut dhe financave janë të integruara.

Nëse bankat që operojnë në Kosovë synojnë të centralizojnë zbatimin e kërkesave të përllogaritje së rënjes në vlerë sipas SNRF 9 në të gjitha njësitë e grupit dhe të përdorin politika, metodologji, skenarë, dhe interpretime të ngjashme në të gjithë grupin, ato duhet të marrin në konsideratë specifikat lokale të filialeve (për shembull, rregullimet në skenarët e centralizuar të marrin në konsideratë kushtet ekonomike lokale) si në grup ashtu edhe në nivel njësie. Kjo do të sigurojë që vlerësimi i humbjeve të pritshme kreditore i reflekton këto veçori, në vend që të zbatohen praktikatat e kontabilitetit "një-masë-për-të-gjithë" brenda grupeve. Ky është gjithashtu rekomandimi i Autoritetit Bankar Evropian.

**Për shkak të rëndësisë së madhe që përllogaritja e rënjes në vlerë mund të ketë mbi Pasqyrën e të Ardhurave dhe për shkak të përfshirjes së Bordit, është me të vërtetë e nevojshme të bëhet një vlerësim i ndikimit sa më shpejt të jetë e mundur**

Të gjitha këto sfida zëvendësohen nga një sfidë e qeverisjes. Qeverisja është parimi i parë që Komiteti i Baselit lëshoi për humbjet e pritshme. Aty thuhet se Bordi është përgjegjës për nivelin e rënjes në vlerë të kredive, për nivelin e humbjes së pritshme të kredive, dhe është përgjegjës për kontrollet dhe konsistencën që kemi në hendekun e kontabilitetit dhe udhëzimeve të mbikëqyrjes. Pra, kjo është një sfidë e vërtetë për të siguruar që gjithçka që ndodh është nën mbikëqyrjen dhe qeverisjen e Bordit.

Kështuqë Bordi të ketë të gjithë informacionin e nevojshëm në mënyrë që t'i jap projektit të përllogaritjes së rënjes në vlerë prioritetin dhe burimet e duhura. Pra, në përgjithësi, procesi i zbatimit të SNRF 9 mund të përmbledhet në dy pika kryesore. Pika e parë është modelet e riskut. Kjo është një rrymë shumë e rëndësishme dhe do të përcaktojë nivelin e shumave të rënjes në vlerë të kredive, përkatësisht nivelin e variacioneve në Pasqyrën e të Ardhurave. Pika e dytë janë sistemet dhe burimet. Duhet të sigurohet që këto dy rryma të kryhen nën udhëheqjen e përpiktë të Bordit.

## SIGURIMI I AFTËSISË PAGUESE FINANCIARE NËPËRMJET SHITJES SË BORXHIT

Në dekadën e fundit, bota dhe BE-ja në veçanti përjetuan kohë të papritura por shumë të turbullta ekonomike.

**Që nga viti 2007, tregu u trondit nga një numër ngjarjesh të rëndësishme që çuan në krijimin e grumbujve të mëdha të borxhit të keq që në fillim të vitit 2017 ku arritën në afërsisht 1 trilionë Euro vetëm në BE.**

Ngritja e shqetësimeve të rregullatorëve ka sjellur kërkesa më të rrepta për Basel III, të shpallura në vitin 2011, me një datë përfundimtare të zbatimit në vitin 2019, si dhe SNRF 9 që pritet të hyjë në fuqi që nga viti 2018. Basel III, megjithëse ende nuk zbatohet plotësisht është pothuajse bisedë e kaluar pasi që Basel 4 është duke u konsideruar tashmë. Të dyja këto synojnë të forcojnë kapitalin e bankave, të cilat duhet të arrihen me përmirësimin e likuiditetit dhe uljen e borxhit të përdorur për të financuar asetet. Sipas SNRF 9, bankat do të duhet të vendosin modele të rrezikut bazuar në humbjet e pritura dhe jo të ndodhura, që do të thotë që edhe ekspozimet performuese do të duhet provizionuar.

**Rritja e portofoliove të këqija, trendi i zbatimit të kërkesave më të rrepta për kapital dhe rritja e shpalosjes së fakteve financiare, si dhe kriza e tejzgjatur e Euros dhe normat e ulëta të interesit, kanë sfiduar bankat që të kërkojnë zgjidhje të besueshme, moderne, të shpejta, dhe të sigurta për menaxhimin e rrezikut.**

Deri në 44% e të gjitha kompanive në Europë punësojnë transferime (outsourcë) për t'u marrë me portofoliot e borxhit. Shumica e bankave kanë bashkëpunim afatgjatë me agjencitë profesionale të mbledhjes për shërbimet e arkëtimit të borxheve, por gjithnjë e më shumë banka dhe institucione

### ZNJ. KATERINA BOSEVSKA

DREJTORESHË  
MENAXHUESE,

EOS MATRIX L.L.C.  
DEGA NË KOSOVË



financiare po inkorporojnë shitjet e borxhit në strategjitë e tyre të menaxhimit të rrezikut. Në një deklaratë për shtyp nga Marsi i vitit 2017, Banka Qendrore Evropiane (BQE) në udhëzimet e saj për bankat se si të trajtojnë kreditë jo-performuese përqendrohet në faktin që niveli i lartë i KJP ndërhyr në aftësinë e bankave për të dhënë hua dhe kërkon kohë të vlefshme të menaxhimit. Një nga sugjerimet se si të trajtohen KJP është pikërisht opsioni i shitjes së borxhit. Deri kohët e fundit, dhe kryesisht për shkak të koston së ulët të kapitalit, bankat nuk ndjenin presion ekonomik për të shitur KJP-të, por presioni rregullator po rritet, përderisa vëllimet e borxhit të keq po rriten.

**Bankat jo vetëm që do të shesin portofoliot e borxhit të keq, por do të përqendrohen në shitjet e portofolios aktive.**

Sipas një raporti të Deloitte në vitin 2015, shuma e shitjeve të borxhit të mbyllura në 30 vende të BE-së arriti në 104 miliardë Euro. Në vitin 2016, shuma e transaksioneve të mbyllura mbeti pothuajse e njejtë (103 miliardë Euro), me 70 miliardë në transaksione të vazhdueshme deri në fund të vitit. Në vitet e fundit tregjet më aktive për shitjet e borxhit ishin Italia, Spanja, dhe rajoni i Europës Qendrore Lindore, për të cilat ekspertët thonë se kanë një potencial edhe më të lartë në vitet e ardhshme. Përveç kësaj, **meqenëse rregulloret po bëhen më të rrepta, pritet**

**që bankat jo vetëm të shesin portofoliot e borxhit të keq, por do të japin fokus primar në shitjet e portofolios aktive. Kjo tashmë është pjesë e strategjisë së menaxhimit të rrezikut të disa bankave të mëdha dhe tashmë po ndodh në gjithë Europën dhe rajonin e Ballkanit.**

Shitja e borxhit thjesht nënkupton transferimin e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve, si dhe rrezikun e mbledhjes që rrjedhë nga një kontratë kredie, nga kreditori origjinal tek një pronar i ri i borxhit, i cili do të paguajë një shumë të rënë dakord kreditorit origjinal për transferimin e këtyre të drejtave dhe detyrimeve.

Tregu ofron dy lloje të marrëveshjeve të shitjes së borxhit:

- Shitjet e portofolios one-off- të përshtatshme për portofolio të KJP dhe bazuar në shitje të çdo portofolio
- Shitjet rrotulluese (revolving) - të përshtatshme për portofolio aktive (pak ditë në vonesë për shkak të mospagesës) si një marrëveshje e rregullt dhe pjesë e integruar e një strategjie optimale të menaxhimit të rrezikut

Duke shitur një portofolio borxhi shitësi përfiton nga:

- efektet pozitive në bilanc të gjendjes
- rrjedhja e menjëhershme e parasë për investime të reja
- mundësia për të parashikuar flukset monetare të ardhshme nga shitjet e borxhit
- koha për t'u përqendruar në biznesin kryesor
- kursimi i kohës dhe energjisë në kontabilitet
- zvogëlimi i kohës së nevojshme për menaxhimin dhe raportimin e KJP
- eliminimi i të gjitha shpenzimeve të ardhshme të lidhura me arkëtimin e borxheve të këqija
- zvogëlimi i shpenzimeve fikse dhe të përgjithshme

Përveç kësaj, një partner i besueshëm në procesin e shitjes së borxhit do të:

- kushtojë kohë dhe burime që i ndihmojnë shitësit të kuptojë modelin
- transferojë njohuritë në lidhje me zbatimin e modelit

- kushtojë kohë dhe burime për të kuptuar pozitën në treg, strategjinë, dhe portofolion e shitësit si një mënyrë për të arritur në një çmim të drejtë
- përpunojë të arkëtueshmet e blera në mënyrë të ligjshme dhe etike, duke mbrojtur reputacionin e mirë të shitësit

Çmimi i paguar për një portofolio të borxhit varet nga cilësia e portofolios së shitur dhe llogaritet çdo herë që një kontratë e re e shitjes së borxhit është rënë dakord. Në shitjet e portofolios one-off, çdo portofolio shitet nën një kontratë tjetër, ndërsa në shitjet rrotulluese (revolving) të portofolios, një kontratë mund të zgjasë për një periudhë të zgjatur kohore duke përfshirë shitjen e portofoliove të shumëfishta me cilësi të krahasueshme.

Procesi i shitjes së borxhit fillon me nënshkrimin e një NDA ndërmjet shitësit dhe blerësit nga e cila pikë, me një partner serioz dhe të besueshëm të blerjes, zakonisht nuk merr më shumë se tre javë për të finalizuar marrëveshjen. Procesi në vete duhet të jetë i thjeshtë, i drejtëpërdrejtë, dhe pa ndërprerje, i cili gjithashtu ndikohet shumë nga cilësia dhe profesionalizmi i partnerit blerës.

---

**Furnizuesi i shërbimit të shitjes/ blerjes së borxhit duhet të përzgjidhet me shumë kujdes dhe përveç qasjes profesionale në procedurën e përcaktimit të çmimit të blerjes, gjithashtu duhet të jetë në gjendje të sigurojë mbështetjen e klientit, ofrimin e shërbimeve të vazhdueshme, kuptimin e klientit, fleksibilitetin, dhe kodin etik të sjelljes.**

---



EOS Matrix është pjesë e Grupit EOS, një nga kompanitë më të mëdha ndërkombëtare të shërbimeve financiare me 40 vjet përvojë në menaxhimin e arkëttimeve, një nga blerësit më të mëdhenjë të borxhit në Europë, me më shumë se 20,000 klientë në mbarë botën.



## SNRF 9 DHE NDRYSHIMET KRYESORE NË SNK 39

### ZNJ. ARTA LIMANI

MENAXHER I LARTË

DELOITTE KOSOVA  
SH.P.K.



### Z. ARIAN META

MENAXHER

DELOITTE KOSOVA  
SH.P.K.



Futja e kërkesave të reja në SNRF 9 *Instrumentet Financiare* do të jetë një ndryshim i rëndësishëm në raportimin financiar të bankave. Do të ndikojë shumë palë të interesit duke përfshirë investitorët, rregullatorët, analistët, dhe auditorët. Duke pasur parasysh rëndësinë e bankave në tregjet globale kapitale dhe në ekonominë e gjerë, zbatimi efektiv i standardeve të reja ka potencial për të përfituar shumë palë. Në anën tjetër, një implementim me cilësi të ulët në bazë të qasjeve që nuk janë të përshtatshme për këtë qëllim rrezikon të dëmtoj besimin në rezultatet financiare të bankave.

Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) publikoi versionin përfundimtar të SNRF 9 *Instrumentet Financiare* në Korrik 2014. SNRF 9 zëvendëson SNK 39 *Instrumentet Financiare*: Njohja dhe Matja, dhe është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018. Aplikimi më i hershëm është i lejuar. Standardi i ri synon të thjeshtojë kontabilizimin e instrumenteve financiare dhe të adresojë mangësitë e perceptuara të cilat u theksuan nga kriza e fundit financiare.

Koha po mbaron. Bankat që raportojnë sipas SNRF-ve duhet të zbatojnë SNRF 9 *Instrumentet Financiare* në pasqyrat financiare të vitit 2018. Për të qenë gati, bankat duhet të përfundojnë një projekt të madh multidisiplinor duke kombinuar aftësitë e financave, rrezikut, dhe IT-së. Projekti do të kërkojë qeverisje të fortë dhe kontrollë të brendshme për t'iu

dhënë besim të gjitha palëve të interesit në informacionin financiar që rezultojnë. Për shumë banka, adoptimi i kontabilitetit të humbjeve të pritshme të kredisë do të jetë ndryshimi më i rëndësishëm kontabël që kanë përjetuar, edhe më i rëndësishëm se kalimi i tyre në SNRF.

**Ndryshimet kryesore** midis SNRF 9 dhe SNK 39 janë përmbledhur më poshtë.

### Ndryshimet në fushëveprim

- Instrumentet financiare që janë në fushëveprimin e SNK 39 janë gjithashtu në fushëveprimin e SNRF 9. Megjithatë, në përputhje me SNRF 9, një njësi ekonomike mund të përcaktojë disa instrumente që i nënshtrohen përjashtimit të përdorimit me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL); prandaj, SNRF 9 do të zbatohet për këto instrumente.
- Kërkesat e çvlerësimit sipas SNRF 9 zbatohen për të gjitha angazhimet e huasë dhe aktivet kontraktuale në fushëveprimin e SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Konsumatorët.

### Ndryshimet në Klasifikim dhe Matje

- Kategoritë e klasifikimit për aktivet financiare sipas SNK 39 të mbajtura deri në maturim, huatë dhe llogaritë e

arkëtueshme, vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL), dhe të përshtatshmet për shitje përcaktojnë matjen e tyre. Këto janë zëvendësuar në SNRF 9 me kategoritë që reflektojnë matjen, respektivisht koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI), dhe vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL).

- SNRF 9 bazon klasifikimin e aktiveve financiare në karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale dhe modelin e biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e aktivitetit financiar, ndërsa SNK 39 bazon klasifikimin në përkufizime specifike për secilën kategori. Në përgjithësi, kërkesat për klasifikimin e aktiveve financiare të SNRF 9 konsiderohen si të bazuara më shumë në parime sesa SNK 39.
- Sipas SNRF 9, derivativët e përfshirë nuk janë të ndarë (ose të bifurkuar) nëse kontrata bazë është një aktiv brenda fushëveprimit të standardit. Përkundrazi, e gjithë kontrata hibride vlerësohet për klasifikim dhe matje. Kjo e largon vlerësimin kompleks të bifurkimit të SNK 39 për kontratat bazë të aktiveve financiare.
- Sipas SNK 39, aktivitetet/detyrimet financiare derivative të lidhura dhe të shlyera nga ofrimi i instrumenteve të kapitalit të pakuotuar, vlera e drejtë e të cilave nuk mund të përcaktohet në mënyrë të besueshme kërkohet të maten me kosto. SNRF 9 heq këtë përjashtim të koston për aktivitetet/detyrimet financiare derivative; prandaj, të gjitha detyrimet derivative do të maten me FVTPL.
- SNK 39 lejon disa investime të kapitalit në kompani private për të cilat vlera e drejtë nuk është e përcaktueshme në mënyrë të besueshme të matet me kosto, ndërsa sipas SNRF 9 të gjitha investimet e kapitalit maten me vlerën e drejtë.
- Për disa detyrime financiare të përcaktuara me FVTPL sipas SNRF 9, ndryshimet në vlerën e drejtë që lidhen me rrezikun e kreditit të një njësie ekonomike njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse (OCI) ndërsa ndryshimi i mbetur në vlerën e drejtë njihet në fitim ose humbje. Përjashtimet nga ky parim i njohjes përfshijnë kur ky trajtim krijon ose

zgjeron një mospërputhje kontabël dhe gjithashtu nuk zbatohet për angazhimet e huasë ose kontratat e garancisë financiare të përcaktuara me FVTPL. Në raste të tilla, SNRF 9 kërkon njohjen e të gjitha ndryshimeve me vlerën e drejtë në fitim ose humbje.

- Riklasifikimi i aktiveve financiare sipas SNRF 9 kërkohet vetëm kur një njësi ekonomike ndryshon modelin e saj të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare dhe është e ndaluar për pasivete financiare; prandaj, riklasifikimet pritet të jenë shumë të rralla.

## Çvlerësimi

- SNRF 9 zbaton një model të vetëm çvlerësimi për të gjitha instrumentet financiare që i nënshtrohen testimit të çvlerësimit, ndërsa SNK 39 ka modele të ndryshme për instrumente të ndryshme financiare. Humbjet nga çvlerësimi njihen në njohjen fillestare, dhe në çdo periudhë raportimi pasuese, edhe nëse humbja nuk ka ndodhur ende.
- Përveç ngjarjeve të kaluara dhe kushteve aktuale, parashikime të arsyeshme dhe mbështetëse që ndikojnë në arkëtueshmëri konsiderohen gjithashtu kur përcaktohet shuma e çvlerësimit në përputhje me SNRF 9.

Kërkesat për çvlerësim sipas SNRF 9 janë dukshëm të ndryshme nga ato sipas SNK 39. Në vijim theksohen dallimet kryesore midis dy standardeve.

## SNK 39 Modeli i humbjes së pësuar

- Vonon njohjen e humbjeve të kredisë deri sa të ketë dëshmi objektive të çvlerësimit.
- Vetëm ngjarjet e kaluara dhe kushtet aktuale merren parasysh gjatë përcaktimit të shumës së çvlerësimit (d.m.th. efektet e ngjarjeve të ardhshme të humbjes së kredisë nuk mund të merren parasysh edhe kur ato pritet të ndodhin).
- Modele të ndryshme të çvlerësimit për instrumente të ndryshme financiare që i nënshtrohen testimit të çvlerësimit, duke përfshirë investimet e kapitalit të klasifikuara si të përshtatshme për shitje.

## SNRF 9 Modeli i humbjes së pritshme të kredisë

- Humbjet e pritshme të kredisë (ECL) njihen në çdo periudhë raportimi, edhe nëse nuk ka pasur ndonjë ngjarje aktuale të humbjes.
- Përveç ngjarjeve të kaluara dhe kushteve aktuale, informacioni i arsyeshëm dhe mbështetës i të ardhmes që është i disponueshëm pa kosto dhe përpjekje të panevojshme, konsiderohet në përcaktimin e çvlerësimit.
- Modeli do të zbatohet për të gjitha instrumentet financiare që i nënshtrohen testimit të çvlerësimit.

## Qasja e përgjithshme (ose tre faza) e çvlerësimit

Qasja e përgjithshme e SNRF 9 mbi njohjen e çvlerësimit është e bazuar në një proces prej tri fazash, i cili synon të reflektojë përkeqësimin e cilësisë kreditore të instrumentit financiar.

- Faza 1 mbulon instrumentet që nuk kanë pësuar përkeqësim të ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose (ku aplikohet thjeshtësimi opcional i rrezikut të ulët të kredisë) që kanë rrezik të ulët të kredisë.
- Faza 2 mbulon instrumentet financiare që kanë pësuar përkeqësim të ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare (përveç, nëse thjeshtësimi i rrezikut të ulët të kredisë është aplikuar dhe është relevant), por, që nuk kanë dëshmi objektive të një ngjarjeje të humbjes së kredisë.
- Faza 3 mbulon aktivet financiare për të cilat ka dëshmi objektive të çvlerësimit në datën e raportimit.

Humbjet e pritshme të kredisë brenda periudhës 12 mujore njihen në fazën 1, përderisa humbjet e pritshme të kredisë përgjatë jetës së instrumentit njihen në fazën 2 dhe 3.

## Çfarë janë “humbjet e kredisë”?

